

Fall 9-2015

BENIFITET E AUDITIMIT TË JASHEM DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Donjeta Imeri

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the Business Commons



Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

**BENIFITET E AUDITIMIT TË JASHEM DHE AUDITIMIT TË
BRENDSHËM**

Shkalla Bachelor

Donjeta Imeri

Shtator / 2015
Prishtinë



Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

Punim Diplome
Viti akademik 2012-2013

Donjeta Imeri

**BENIFITET E AUDITIMIT TË JASHEM DHE AUDITIMIT TË
BRENDSHËM**

Mentori: Dr.Bukurie Jusufi

Shtator, 2015

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të pjeshme
për Shkallën Bachelor

ABSTRAKT

Objektivi kryesor i këtij punimi është që të ofrojë një kuadër të plotë konceptuale mbi auditimin e brendshëm dhe auditimin e jashtëm duke përfshirë benifitet të cilat mund të sjellën nga këto dy lloje të auditimit.

Për të përmbushur këto objektiva në material janë përdorur të dhëna nga vëzhgime dhe publikime të ndryshme në lidhje me auditimin.

Auditimi në përgjithësi përmban në vetë shumë përgjegjësi duke përfshirë këtu çdo kompani pa marrë parasysh a është një kompani e madhe apo e vogël apo kompani në sektorin privat apo në atë publik.

Sic vërehet në vendin tonë shumë kompani edhe ja kanë frikën auditimit e posaçërisht auditimit të jashtëm sepse ky lloj i auditimit i qetë në pah të gjitha përfitimet të cilat shumica e kompanive jo të gjitha përfitimet i cekin në librat kontabël.

Në këtë punim të diplomës do të paraqes të dhëna të ndryshme të cilat do ti marr nga burimet e ndryshme siç janë marrja e të dhënave nga portalet dhe ueb faqet e ndryshme , librat dhe punime shkencore pra të dhënat të cilat do të përdoren në këtë punim do të jenë të dhëna primare dhe të dhëna sekondare të cilat do ti sqarojnë benifitet të cilat sjellin sikurse auditimi i brendshëm ashtu edhe auditimi i jashtëm në cilëndo kompani.

MIRËNJOHJE/FALENDERIME

Një falënderim për profesoreshën time udhëheqëse të kësaj teme prof. Bukurie Imeri Jusufi e cila asnjëherë nuk u kursye të më jap këshilla shumë të nevojshme për finalizimin me sukses të kësaj teme .

Një falënderim për familjen time e cila më ka mbështetur në çdo moment të vështirë gjatë studimeve të mija si dhe më ka inkurajuar gjithmonë në rrugën time drejt të ardhmes. Gjithashtu falënderoj në mënyre të veçantë të fejuarin tim dhe të gjithë ata miq, të afërm e kolegë të cilët më mbështetjen e tyre më inkurajuan të vazhdoj më të drejt rrugës së dijës.

PËRMBAJTJA

FJALORI I TERMAVE.....	6
1 HYRJE.....	7
2 SHQYRTIMI I LITERATURËS (HISTORIKU).....	9
2.1 Studimet pro kësaj doktrine.....	12
2.2 Studimet kundër kësaj doktrine.....	14
3 DEKLARIMI I PROBLEMIT.....	16
4 METODOLGJIA.....	17
5 REZULTATET.....	18
6 DISKUTIME DHE PËRFUNDIME.....	27
7 REFERENCAT.....	31

FJALORI I TERMAVE

IIA-Institute of International Auditor (Instituti i Auditorëve të Brendshëm).

AICPA- Assurance Services Executive Committee's Emerging Assurance Technologies.

Task Force (Komiteti i sigurimeve të shërbimit ekzekutiv).

COSO-The Committee of Sponsoring Organization's of the Treadway Commission (Komiteti i Sponsorizimit, Organizimi i Komisionit Treadway).

IAASB-(Bordi Ndërkombëtar për Standardet e Auditimit dhe Sigurisë).

1. HYRJJE

Kjo temë e diplomës ka të bëjë me benifitet që mund të sjellin auditimi dhe auditimi i jashtëm dhe auditimi i brendshëm. Në të gjitha kompanitë dhe ndërmarrjet jo vetëm në Kosovë por në mbare botën sikur auditimi i jashtëm ashtu edhe auditimi i brendshëm kanë një rol mjaft të rëndësishëm. Auditimi i brendshëm ashtu sikurse edhe auditimi i jashtëm do të shtjellohen në punimin tim , po ashtu do të tregohen edhe karakteristikat , rëndësia si dhe ndikimi i tyre në kompanitë e ndryshme.

Pra në këtë punim të diplomës do të këtë arsye dhe fakte mjaft të rëndësishme të cilat do të merren nga burimet e ndryshme të cilat janë të dhëna primare dhe të dhëna sekondare , të cilat do ta bëjnë lexuesin që të vazhdoj më tutje më leximin e këtij punimi të diplomës.

Pra qëllimi kryesor i temës time të diplomës është që të tregoj se cilat janë benifitet që sjellin auditimi i brendshëm dhe auditimi i jashtëm në çdo kompani të vendit tonë , po ashtu do të sqarojë se auditimi në përgjithësi sjellë vetëm të mira për çdo kompani , pra nuk sjellë asgjë të keqe por vetëm përfitime për çdo ndërmarrje qoftë publike apo private.

Pritja ime nga ky punim i diplomës është që të mësoj se cilat janë përfitimet më të mëdha që mund ti sjellë auditimi si dhe cilët janë hapat për të arritur deri tek auditimi i duhur .

Deklarimi i problemit në këtë e temë është që të tregoj se: Cilat janë benifitet që sjellin auditimi i jashtëm dhe auditimi i brendshëm në përgjithësi? Në shumicën e rasteve kompanitë në Kosovë mundohen që ta shmangin në shkallë shumë të lartë auditimin , e në përgjithësi në një përqindje mjaft të lartë auditimin e jashtëm.

Në këtë punim do të jenë të paraqitura informatat në detale për të mirat që sjellin auditimi i brendshëm dhe auditimi i jashtëm. Në pjesën e parë të këtij punimi të diplomës do të përfshihen shqyrtimi i literaturës ku në shqyrtimin e literaturës do të paraqiten studimet që për bazë kanë marrë doktrinën e fuqisë së tregut (studimet pro dhe kundër kësaj doktrine) , po ashtu do të paraqiten studimet që për bazë kanë marrë doktrinën e produktivitetit (studimet pro dhe kundër kësaj doktrine)

Kurse në pjesën e dytë të këtij punimi të diplomës janë të paraqitura burimet nga të cilat kam përdorur të dhënat , pra në përgjithësi do të tregohet metodologjia e temës. Ndërsa në pjesën e tretë përfshihen rezultatet te cilat janë të cekura si rezultati A dhe rezultati B , pra me këto rezultate kam ardhur në përfundim dhe kam treguar se çfarë benifite mund të sjellin auditimi i brendshëm dhe auditimi i jashtëm në përgjithësi në vendin tonë. Në pjesën e katërt në këtë punim bëjnë pjesë konkluzionet , pra në përfundim të kësaj teme do të tregoj se si auditimi i brendshëm gjithashtu edhe ai i jashtëm kanë benifite të shumta të cilat ju ofrohen organizatave të ndryshme.

2. SHQYRTIMI I LITERATURËS (HISTORIKU)

Në këtë temë të diplomës kam përdorur material nga punimet e ndryshme shkencore , portale , libra shkencor si dhe nga ueb faqet e ndryshme të internetit. Njëra ndër arsyt kryesore se pse kam përdorur informata nga punimet shkencore si dhe librat shkencor ka qenë sepse po në ato punime dhe librat shkencor ka pasur material të bollshëm të cilat kanë pasur një kualitet të lartë dhe një lidhje të madhe për temën time dhe më ka bërë që ti përdor po ato gjëra të njëjta.

Arsyeja pse kam përdorur informatat nga portalet dhe ueb faqet e ndryshme të internetit ka qenë sepse ka pasur shumë informata në lidhje më auditimin e brendshëm dhe auditimin e jashtëm ndër vite , gjë që mua më ka ndihmuar aq shumë në mbledhjen e informatave të ndryshme në lidhje po me këtë temë. Sa i përket ndërlidhjes së këtij punimi me temën time duhet të cekim se ndërlidhja është mjaftë e madhe. Në përgjithësi materialin të cilin e kam mbledhur për këtë temë që është rreth auditimit të brendshëm dhe auditimit të jashtëm , efekteve të tyre , mënyrës se si ndikojnë tek kompanitë e mëdha dhe ato të vogla , si dhe benifitet që kanë sjellë në kompanitë e ndryshme . Historia e auditimit është mjaft e hershme , qe ne kohet e lashta njerëzimit, ata te cilit kishin prona iu lind nevoja për shqyrtimin e hollësishëm te veprimeve te tyre ekonomike qe kryenin çdo dite. Pra domosdoshmëria e transparencës ne administrimin e pasurisë pate nevojën për fillimin e legjimitetit te shërbimeve te auditimit po ashtu edhe te kontabilitetit

Fjala *auditim* rrjedh prej fjalës latinë “*audire*” që ne anglisht do të thotë dëgjim, pra të dëgjosh, por ne fakt edhe ne Romen Antike fjala “*auditorium*” tregonte trupën e gjykatës. Kuptimi i fjalës *auditim* qe ne epokat e largëta kryesisht është i lidhur me gjykimin po ashtu edhe me vlerësimin e veprimtarive , pra është e evidente qe termi *auditim* ka ruajtur një kuptim origjinal qe lidhet me verifikimin , rishikimin , investigimin , ekzaminimin , gjykimin po ashtu edhe dhënien e opinionit mbi një veprimtari apo aktivitet po ashtu mjaft larg nga koncepti i kontrollit dhe i verifikimit te cilëve ky kontekst u referohet ne vendet siç është Kosova. Pra ne këtë kuptim fjala “*auditor*” qe ne shqip d.m.th auditues përdoret për te treguar atë qe e verifikon dhe e kontrollon grupin punues apo individin ndërsa fjala “*auditing*” e qe ne shqip d.m.th *auditim* përdoret për te treguar atë e cila lidhet me procesin pra me qëllimin , misionin , rolin dhe funksionin e veprimtarisë.

Domethënien e nocionit “*Auditim*”, auditorët dhe institucionet e definojnë në mënyra të ndryshme , ku definicioni i cili përdoret në shumicën e rasteve për auditimin thotë se : Auditimi është proces i sistematizuar i mbledhjes dhe krijimit të argumenteve mbi veprimtarinë ekonomike dhe rezultatet me qëllim që të konstatohet baraspesha në mes të raporteve të afarizmit dhe kriteriumeve të parashtruara dhe kjo tu dërgohet shfrytëzuesve të interesuar. Pra auditimi është ekzaminimi i regjistrave kontabël të njësisë ekonomike, si dhe inspektimi fizik i aseteve të saj. Nëse kryhet nga një kontabilist i certifikuar publik (CPA), CPA mund të shprehim një opinion mbi drejtësinë e pasqyrave financiare të njësisë ekonomike. Ky mendim është lëshuar më pas së bashku me pasqyrat financiare ndaj komunitetit të investimeve

Përfundimisht në qoftëse i referohemi historisë të zhvillimit dhe veprimtarisë të auditimit dhe klasifikimit sipas tipave të auditimit kuptohet lehtësisht se auditimi ndahet në dy lloje veprimtarish të mëdha siç janë:

1) Auditimi i Jashtëm

2) Auditimi i Brendshëm.

Auditimi i jashtëm në kuptimin e plotë të fjalës ka filluar që në momentin e nevojës për auditim si një shërbim për të audituar punën e drejtuesve dhe administratoreve në mënyrë për të raportuar pronarit mbi këtë veprimtari. Objekti kryesor i auditimit të jashtëm është : ekzaminimi i pasqyrave financiare po ashtu certifikimi i bilancit mbi veprimtarinë financiare-ekonomike vjetore dhe testimi i transaksioneve historike financiare.

Historikisht audituesit e brendshëm punën e tyre e kanë kufizuar siç është në auditimin e të gjithave veprimtarive financiare apo edhe në sisteme të tjera siç janë: sistemi i pagave , sistemi i të ardhurave , sistemi i pagesave për mallra po ashtu edhe për shërbime etj. Auditimi i brendshëm është zhvilluar sikur një mjet i menaxhimit i cili ka pasur për synim shtimin e vlerës të organizatës por jo vetëm duke e raportuar faktet por para se të gjithash duke e parandaluar që të ndodhin gabimet duke identifikuar fushat për përmirësime përmes zbatimit të praktikave më të mira profesionale.

Ndërsa porsa i përket auditimit të brendshëm në përgjithësi është theksuar se auditimi i brendshëm është një aktivitet tërësisht i pavarur i cili është një objektiv për vlerësimin e informacionit si po ashtu ndihmon për të verifikuar saktësinë e tyre duke iu dhënë këshilla menaxhimit për të kontribuar në përmirësimin e punës së subjekteve.

Kjo ndihmon subjektet për të përmbushur objektivat e tyre, duke sjellë një qasje sistematike dhe të disiplinuar për të vlerësuar e për të përmirësuar proceset e kontrollit dhe të qeverisjes së njësisë publike dhe frytshmërinë e menaxhimit të riskut.

Auditimi i brendshëm është veprimtari që realizohet nga punonjësit e një kompanie, organizate i cili mbulon të gjitha operacionet e organizatës po ashtu mbulon edhe menaxhimin e riskut .

Auditimi i brendshëm punon periodikisht gjatë gjithë vitit i cili është i pavarur nga opinioni i klientëve po ashtu është i detyruar për çdo kompani i cili emërohet nga aksionarët dhe duhet të raportoj po te ata .

Një auditim i brendshëm mund të trajtojë një gamë të gjerë çështjesh, të tilla si punonjës përputhje me politikat e korporatave. Auditimi i përputhshmërisë zakonisht trajton përputhshmërinë e një njësie ekonomike me rregullat dhe rregulloret e një agjencie të qeverisë.

Qëllimi i Auditimit të brendshëm është përcaktuar në standardin 2110 A2 të IIA-së, ku përcaktohet se : “Veprimtaria e auditimit të brendshëm duhet të vlerësojë ekspozimin ndaj riskut i cili ka të bëjë me qeverisjen, operacionet e organizatës/njesisë, dhe sistemin e informacionit në lidhje me:

- Besueshmërinë dhe integritetin e informacioneve financiare dhe operationale;
- Efektivitetin dhe eficientën e operationeve;
- Ruajtjen e aseteve; dhe
- Përputhjen me ligjet, rregulloret dhe kontratat”.

Auditimi i jashtëm është një veprimtari e lidhur nga jashtë organizatës ose veprimtari që realizohet nga institucioni kryesor i auditimit i cili mbulon kryesisht sistemet financiare dhe të kontabilitetit që ndikojnë në rezultatin financiar ,auditimi i jashtëm punon një pjese të komës gjatë vitit i cili është i varur nga emëruesi i tij dhe është i rekomanduar për një numër të madh të kompanisë por nuk ka asnjë kërkesë ligjore në shumicën e vendeve P.sh Në Britaninë e Madhe për momentin emërohet nga drejtorët dhe raporton po tek ata. Nga të dhënat e mbledhura kam vërejtur që auditimi i jashtëm dhe i brendshëm sjellin benifite të shumta për organizatat e ndryshme të vendit.

Në Kosovë sipas ligjit për kontabilitet dhe për financa , jo të gjitha bizneset kanë obligim që të ju nënshtrohen procesit të auditimit . Sipas këtij ligji këtij procesi i nënshtrohen vetëm kompanitë e mëdha , kurse ndërmarrjet e vogla dhe të mesme bëjnë vetëm raportimin financiar.

2.1 Studimet pro kësaj doctrine

Ekzistojnë studime të shumta të cilat e mbështesin auditimin pa marrë parasysh se a është auditim i brendshëm apo auditim i jashtëm, më poshtë janë cekur edhe disa nga mendimet e ndryshme të disa organizatave dhe disa autorëve të librave të ndryshme të cilat i përkasin auditimit në përgjithësi . AICPA-ja e përkufizon auditimin e vazhdueshëm si" *Një metodologji që u mundëson revizorëve të pavarur për të dhënë sigurimi të shkruar në çështje duke përdorur një seri të auditorëve*"(AICPA,1999).

"Procesi i auditimit , ndikohet nga bordi i drejtorëve, menaxhmenti i njësisë ekonomike personeli , zbatohet në përcaktimin e strategjisë dhe nëpër ndërmarrje , i projektuar për të identifikuar ngjarjet potenciale që mund të influencojnë entitetin , dhe për të menaxhuar rrezikun për jetë, për të ofruar siguri të arsyeshme në lidhje me arritjen e objektivave " (COSO,2004) . Procesi i auditimit qoftë i jashtëm apo i brendshëm ka një rol mjaft të rëndësishëm për organizatat e ndryshme.

"Roli i ri i auditimit të sektorit publik paraqet tashmë një vizion bashkëkohor,modern që ndërlidh objektin e tij tradicional me objektin e menaxhimit dhe konsultimit në shumë disiplina e sektorë , në përgjithësi një proces i auditimi fokusohet në investigimin e veprimeve të qeverisë nga pikëpamja ekonomike , eficiencës dhe efektivitetit" (Brown et,1992). Siç përcaktohet nga Instituti i Auditorëve të Brendshëm (IIA), *" Auditimi i brendshëm është një veprimtari e pavarur , objektive , e sigurisë e projektuar për të rritur vlerën dhe rregulluar operacionet e organizatës . Auditimi e ndihmon organizatën për të arritur objektivat e saj duke sjellë një qasje të disiplinuar dhe të sistemuar për të vlerësuar dhe për të përmirësuar efektivitetin e menaxhimit të rrezikut , kontrollit dhe proceseve të qeverisjes"* (IIA,2002).

"Pa auditim nuk ka asnjë kontroll dhe në qoftë se nuk ka kontroll atëherë ku është selia e pushtetit?"(Normanton, 1996).

"Auditimi është një proces i mbledhjes së dëshmive . Dëshmitë e auditimit përdoren për të vlerësuar se sa mirë kriteret e auditimit janë duke u përmbushur . Auditimi është objektiv , i paanshëm , dhe i pavarur " (Arter,Dennis ,2002) .

"Auditimi është një dukuri shoqërore e cila si shërben asnjë qellim apo vlere përveç dobia e tij praktike dhe ekzistenca e tij utilitare"(Flint, 1988).

Porter , Simon dhe Hatherly theksojnë që auditimi është " ekzaminimi i pasqyrave financiare të një njësie ekonomike , të cilat janë përgatitur nga menaxhmenti i njësisë ekonomike për përdoruesit e jashtëm , dhe i provave mbështetëse , informatave të përmbajtura në këto pasqyra financiare ". (Porter , Simon dhe Hatherly ,2003)

"Auditimi i jashtëm është një ekzaminim i pavarur i pasqyrave financiare të përgatitura nga organizata . Kjo bëhet zakonisht për qëllime statusore (sepse e kërkon ligji) .

Një rezultat në lidhje me një opinion të auditimit nëse pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë " (Gray, Rob,2000). "Një auditim i brendshëm është projektuar për të shqyrtuar se çfarë një kompani është duke bërë për të identifikuar kërcënimet e mundshme për shëndetin dhe të përfitimit të organizatës po ashtu të bëjë sugjerime për zbutjen e rrezikut të lidhur me këto kërcënime , në mënyrë që të minimizojnë kostot" (Lee, Tanya,2007).

"Auditimi i brendshëm është një profesion dinamik i përfshirë për të ndihmuar organizatat që të arrijnë objektivat e tyre . Ai ka të bëjë me vlerësimin dhe përmirësimin e efektivitetit të proceseve të menaxhimit të riskut , kontrollit dhe qeverisjes në një organizatë" (Mohammad J. Abdolmohammadi, and Priscilla Burnaby ,2006) .

Detyrë kryesore e çdo auditori të brendshëm është ofrimi i ndihmës të organizatave të ndryshme pa marrë parasysh çfarë janë organizatat në të cilat ai është auditor.

Por ekzistojnë edhe shumë mendime të ndryshme pro auditimit të cilat janë të cekura më poshtë:

"Auditimi i jep besueshmëri pasqyrave financiare duke zvogëluar pasigurinë dhe rrezikun" (Broadley,2006). "Investitorët dhe bizneset kanë nevojë për informacione të besueshme, kështu që audituesi luan një rol kyç në mbrojtjen e interesit publik dhe të investitorëve". (Elorrieta, 2002). "Monitorimi i jashtëm i entitetit nga audituesit ndikon në përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të tij"(Ghosh, 2007).

"Auditimet cilësore ndikojnë në besueshmërinë e informacionit financiar i cili zvogëlon rrezikun e investimit"(Fallatah, 2008). "Auditimi ndihmon në gjetjen e gabimeve në raportet financiare " (Hylas & Ashton, 1982). "Institucionet kredidhënëse i konsiderojnë informacionet nga raportet e audituesve si informacione relevante dhe të dobishme" (Guillamon, 2003). "Raporti i audituesit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm jep informacion të rëndësishëm për vendimmarrësit e investimeve" (Shelton & Whittington, 2008).

Ndërsa sipas IAASB " rreziku i auditimit do të rrisë cilësinë e auditimit , si rezultat i vlerësimit më të mirë të rrezikut përmes një kuptim më të hollësishëm të njësive ekonomike dhe mjedisit të saj, duke përfshirë edhe kontrollin e brendshëm, dhe dizajn të përmirësuar po ashtu edhe kryerjen e procedurave të auditimit për t'iu përgjigjur rreziqeve të vlerësuara të materialit anomali" (IAASB,2008).

2.2 Studimet kundër kësaj doktrine

Gjatë viteve të fundit vërehet "një rënie e besimit të qytetarëve tek qeveritë e tyre dhe ajo çfarë është më e rëndësishme, në mënyrën se si punon vetë sistemi qeveritar duke ulur ndjeshëm edhe besimin ndaj procesit të auditimit" (Marlowe ,2004).

Sipas IIA 1220 A3 "Audituesit e brendshëm duhet të jetë vigjilentë ndaj rrisqeve të dukshme të cilat mund të ndikojnë në objektivat, operacionet apo burimet. Megjithatë, procedurat e sigurisë, edhe atëherë kur kryhen me kujdesin e duhur profesional, nuk garantojnë se të gjitha risqet e mundshme do të identifikohen".

Auditori në përgjithësi merr dhe vlerëson evidencën e auditimit për të pasur apo duke marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë ose janë paraqitur në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale , po ashtu nëse ato janë në një përputhje me të aplikueshme financiare në raportimin kornizë.

Koncepti i sigurisë së arsyeshme pranon se ekziston rreziku , opinionin e auditimit është i papërshtatshëm. Rreziku që auditori shpreh një opinion të papërshtatshëm të auditimit kur pasqyrat financiare janë anomali materiale është i njohur si "rrezik i auditimit".

Rreziku i auditimit është një funksion i rrezikut të gabimeve materiale financiare , deklaratat (ose thjesht, "rreziku i anomalive materiale") (p.sh., rreziku që pasqyrat financiare janë anomali materiale para auditimit) dhe rreziku që auditori nuk do të zbulojë keqinterpretimet e tillë ("rrezik të zbulimit"). Rreziku i një auditimi është që mund të gjeni gabime apo kalkulimet e gabuara qëllimisht (d.m.th mashtrim) duke shqyrtuar pasqyrat financiare individuale të një kompanie .

Ka dy kategori të përgjithshme të rrezikut të auditimit e para është e rrezikut që ka të bëjë me vlerësimin e materialeve financiare dhe e dyta është e rrezikut që ka të bëjë me pohimet e prodhuara nga vlerësimi i materialeve financiare.

Rreziku i auditimit është një funksion i riskut të gabimeve materiale dhe rrezikut të zbulimit.
"Prandaj, rreziku i auditimit përbëhet nga dy komponentë - riskut të gabimeve materiale dhe rrezikut të zbulimit".(ACCA,2010)

Nga shqyrtimi i literaturës kam vërejtur që shumica e autorëve theksojnë që auditimi ka një efekt pozitiv dhe personat ju besojnë raporteve të auditorve por ka edhe nga ata të cilët theksojnë që popullsia e ka humb besimin në këto raporte.

3. DEKLARIMI I PROBLEMIT

Në bazë të këtij punimi unë kam kuptuar që në një kompani apo në një ndërmarrje auditimi i brendshëm ndihmon drejtorët duke vlerësuar fushat kryesore të rrezikut nga mashtrimi, vlerësimin e mjaftueshmërisë së sistemeve të kontrollit dhe duke ndihmuar në zhvillimin e kontrolleve. Pra Auditimi është një aktivitet i pavarur dhe objektiv për vlerësimin e informacionit po ashtu për të verifikuar saktësinë e tyre si dhe duke i dhënë këshilla menaxhimit për të kontribuar në përmirësimin e punës së subjekteve. Në përgjithësi çdo kompani mendoj se duhet të ketë një auditim të mirëfilltë me qëllim që të mos bëjë gabime.

Gjatë shqyrtimit të literaturës kam kuptuar se ekzistojnë shumë autor me mendime të ndryshme , disa nga të cilët e mbështetin auditimin në përgjithësi dhe kanë mendimin që auditimi ndikon në mënyrë pozitive në çdo ndërmarrje , ndërsa disa nga autorët e mbështesin auditimin por në një farë mënyre edhe i cekin disa mendime që auditimi përmban rrezik në vete. Por në përgjithësi auditimi e sidomos auditimi i brendshëm ndikon në mënyrë mjaftë pozitive pa marrë parasysh a është ndërmarrje publike apo private.

Në bazë të këtij punimi të diplomës do tu përgjigjem disa pyetjeve që mendoj se janë mjaftë të rëndësishme në lidhje me auditimin.

1. Cilat janë benifitet që sjellin auditimi i jashtëm dhe i brendshëm në përgjithësi?
2. Qfarë përfitime mund të ofron auditimi i brendshëm në një organizatë?
3. Si përfitojnë auditimet e jashtme një game të gjere të përdoruesve ?
4. Qfare përfshinë auditimi i brendshëm?
5. . Qfare mund të ndihmoje auditimi i brendshëm?

4. METODOLGJIA

Të dhënat që i kam përdorur në këtë punim janë të dhëna primare dhe të dhëna sekondare. Pra të dhëna primare të cilat i kam përdorur në këtë punim janë të dhënat të cilat janë marrë nga librat shkencorë. Ndërsa sa i përket të dhënave sekondare apo të dhënat dytësore që janë përdorur në këtë punim janë të dhëna të cilat janë marrur nga faqe të ndryshme të internetit në portale në ueb faqe të ndryshme si dhe nga faqe të internetit të cilat iu takojnë organizatave të ndryshme.

Të dhënat të cilat i kam përdorur tek shqyrtimi i literaturës janë të marrura kryesisht nga librat shkencorë të disa autorëve të ndryshëm, të cilët disa janë të mendimit që auditimi në përgjithësi ndikon në mënyrë pozitive, por ka edhe disa mendime nga disa autorë që cekin se auditimi i brendshëm në përgjithësi përmban rrezik në vetë. Pra të gjitha të dhënat të cilat janë përdorur nga librat shkencorë në këtë punim të diplomës iu përkasin autorëve të ndryshëm siç janë : Arter, Dennis 2002, Porter, Simon dhe Hatherly 2003, Gray 2000, Tanya 2007 etj. Po ashtu në këtë punim diplome kam bërë një analizë të përgjithshme se sa mund të sjellin benifite në kompani të ndryshme auditimi i jashtëm dhe auditimi i brendshëm.

5. REZULTATET

Cilat janë benifitet që sjellin auditimi i jashtëm dhe i brendshëm në përgjithësi?

Përfitimet e një auditimi janë të shumta , auditimi mund të përmirësojë efikasitetin e një kompanie dhe profitabilitetit duke ndihmuar personelin e menaxhimit për të kuptuar më mirë punën financiare dhe sistemet e tyre.

Auditimi në përgjithësi është procedurë e të vërtetuarit dhe vlerësimit të raporteve financiare dhe konsolidimit të raporteve financiare të obliguesve të auditimit të argumenteve dhe metodave të cilat zbatohen me rastin e përpilimit të raporteve financiare në bazë të cilave jepet mendimi profesional dhe i pavarur mbi gjendjen reale dhe objektive financiare , rezultateve financiare . Me poshtë janë të cekura disa faza përmes të cilave mund të trajtohet procedura apo procesi i auditimit:

- Zgjedhja e kriteriumeve përmes të cilave përshkruhet gjendja përkatëse e aktiviteteve të ndryshme ,
- Mbledhja e argumenteve përkatëse mbi aktivitetet e kaluara ,
- Krahasimi i punëve të kryera me kriteriumet e zgjedhura ,
- Përgatitja e raporteve në të cilat trajtohet harmonizimi i punëve të kryera dhe kriteriumeve të zgjedhura.

Auditimi i jashtëm është procedurë e kontrollimit dhe vlerësimit të afarizmit të ndërmarrjes që kryejnë personat profesionist të pavarur dhe auditor të licencuar. Ata nuk mund të jenë të punësuar në atë ndërmarrje dhe të kenë lidhje me ndryshe do të shkelej principi i pavarësisë.

Disa nga karakteristikat kryesore të auditimit të jashtëm janë : auditimi i jashtëm në mënyrë suplementare hulumton afarizmin e ndërmarrjes po ashtu gjatë auditimit të jashtëm kërkohet harmonizimi i afarizmit të ndërmarrjes kjo para se të gjithash i raporteve financiare me kriterijume të përcaktuara më parë me të cilat sigurohet realiteti dhe objektiviteti i raporteve financiare .

Ndërsa auditimi i brendshëm është i inkuadruar në ndërmarrje ku ato e kryejnë auditimin dhe vete e organizojnë , po ashtu e zbatojnë programin e auditimit të brendshëm sikurse një test i përgjithshëm i efikasitetit të të gjithave aspekteve të kontrollit të brendshëm.

Qëllimi kryesor i auditimit intern apo të brendshëm është zhvillimi po ashtu edhe përmirësimi i njësive të brendshme të ndërmarrjes e më pak është i rëndësishëm hulumtimi i mendimit mbi ndodhitë reale të raporteve financiare.

Auditimin intern (brendshëm) e kryejnë personat te cilët janë te punësuar ne ndërmarrje dhe qe e kanë për detyre te organizojnë po ashtu edhe ta zbatojnë programin e auditimit te brendshëm si një test te pergjitheshem për te kontrolluar ekzekutimin e kontrollit te brendshëm dhe afarizmit te ndërmarrjes. Roli auditmit të brendshëm përfshinë monitorimin, vlerësimin, analizimin e rrezikut organizative dhe kontrollet , shqyrtimin dhe konfirmimin e informacionit , përputhjen me politikat, procedurat dhe ligjet. Duke punuar në partneritet me menaxhimin, auditorët e brendshëm sigurojë bordin. Dhe , kur nuk ka vend për përmirësim, auditorët e brendshëm për te pasur një auditim te duhur bëjnë rekomandime për përmirësimin e proceseve, politikave dhe procedurave.

Një auditim i brendshëm është projektuar për të shqyrtuar se çfarë një kompani është duke bërë për të identifikuar kërcënimet e mundshme për shëndetin dhe të përfitimit të organizatës , dhe të bëjë sugjerime për zbutjen e rrezikut të lidhur me këto kërcënime , në mënyrë që të minimizojnë kostot.

Në përgjithësi , një auditim i brendshëm përfshin dy veprimtari kryesore :

